



## Fletëpalosje për tarifën e subvencioneve për kujdesin ndaj fëmijëve të kopshteve dhe shkollave suplementare.

Ju jetoni në Bülach dhe lini fëmijën/ët tuaj për përkujdesje tek një çerdhe, tek një kopsht ditor apo në një parashkollor dhe dëshironi të aplikoni për tarifën e subvencioneve. Bazë për llogaritjen e uljes janë **Rregullorja e Kontributeve (RK)** si dhe **Rregullorja e Zbatimit (RZ)**. Këto dokumenta i gjeni në [www.buelach.ch/bvo](http://www.buelach.ch/bvo).

### Baza e llogaritjes

Bazë për llogaritjen e uljes janë të ardhurat vjetore sipas paragrafëve 1-5 dhe 6.4 të deklarimit të taksave dhe nuk llogariten të ardhurat e tatueshme.

Ju keni paguar tashmë taksën në Bülach

- Nëse ju keni paguar tashmë taksat në Bülach vitin e kaluar, mjafton të plotësoni formularin e aplikimit dhe të dorëzoni kontratën për përkujdesin e fëmijëve në çerdhe apo kopsht ditor ose konfirmimin e regjistrimit të kujdesit suplementar në shkollë.
- Bazuar në autorizimin tuaj, Departamenti i Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë merr shifrat më të fundit të të ardhurave direkt nga zyra e taksave në Bülach dhe llogarit në bazë të këtyre të dhënave zbritjen aktuale. Ju do të informoheni me shkrim në lidhje me nivelin e lejuar të zbritjes.
- Një rilogaritje e kontributeve të qytetit bëhet në rishikimin vjetor, në rast të një vlerësimi të ri tatimor ose **me kërkesë të prindërve në rast të ndryshimit të numrit të fëmijëve ose nëse të ardhurat relevante ndryshojnë dukshëm me më tepër se 10%. Këto ndryshime janë subjekt i raportimit të nenti 11 të RK.**

Ju jeni zhvendosur pak kohë më parë në Bülach dhe nuk keni paguar ndonjë taksë këtu

Ju jeni subjekt i tatimit në burim

Ju jeni në proces ndarje apo jeni divorcuar së fundmi

Të ardhurat tuaja aktuale kanë ndryshuar me më tepër se 10% që nga vlerësimi i fundit përfundimtar i taksave

- Personat, të ardhurat aktuale e të cilëve kanë ndryshuar me më tepër se 10% nga vlerësimi i fundit përfundimtar i tatimeve, do të vlerësohen në bazë të 6 pagave të fundit si dhe rrethanave aktuale financiare.
- **Personat e sapoardhur** për të cilët nuk ka të dhëna tatimore në Bülach, do të vlerësohen në bazë të 6 pagave të fundit si dhe rrethanave aktuale financiare.
- Personat që janë subjekt i **tatimit në burim**, do të vlerësohen në bazë të 6 pagave të fundit si dhe rrethanave aktuale financiare.
- Personat **në proces ndarje apo që janë divorcuar së fundmi**, të cilët nuk jetojnë më në të njëjtën shtëpi, do të vlerësohen në bazë të 6 pagave të fundit dhe çdo pagesë për kujdes dhe ushqim.



## Pagesa

### Britje për përkujdes në çerdhe / në kopshte ditore / parashkollorë privatë

Ju paguani faturën për çerdhen/ kopshtin ditore / parashkollorin privat. Më pas ju i dërgoni rregullisht (çdo muaj deri në maksimalisht çdo 6 muaj) Departamentit të punëve Sociale dhe Shëndetit në Bülach një kopje të faturës si dhe vërtetimin e pagës. Pas kësaj zbritja e kontributeve do të transferohet në llogarinë tuaj.

### Ulje për kujdesin në parashkollor

Ju do të merrni një faturë mujore nga Administrata e shkollës fillore minus uljen.

### Dokumenta që duhen dorëzuar për verifikimin e aplikimit

- Formulari i plotësuar i aplikimit
- Kopje e kontratës së përkujdesit me çerdhen apo kopshtin ditore ose konfirmimin e regjistrimit të kujdesit suplementar në shkollë

nëse është e aplikueshme si shtesë:

- Nëse të ardhurat aktuale vjetore kanë ndryshuar me më tepër se 10% nga vlerësimi i fundit përfundimtar i tatimeve: kopje e 6 pagave të fundit si dhe një dëshmi të aseteve
- Regjistrimi në Agjencitë Rajonale të Punësimit ARP (nëse është regjistruar në ARP)
- Personat e sapoardhur: kopje të 6 pagave të fundit si dhe një dëshmi të aseteve
- Personat që janë subjekt i tatimit në burim: kopje të 6 pagave të fundit si dhe një dëshmi të aseteve
- Personat në proces ndarje apo që janë divorcuar së fundmi: kopje të 6 pagave të fundit, një dëshmi të aseteve si dhe vërtetim të detyrimit për kujdes dhe ushqim

### Dërgo aplikacionin tek:

Stadt Bülach  
Soziales und Gesundheit  
Gesellschaft  
Feldstrasse 99  
8180 Bülach

### Kontakt për pyetje apo këshillim personal

Tel.: 044 863 15 43

E-Mail: [bvo@buelach.ch](mailto:bvo@buelach.ch)